

Protokolli i Mbledhjes Dëgjimi Publik mbi Draft Metodologjinë e Tarifave të Energjisë Elektrike

Data: E enjte, 17 nëntor 2005, ora 14.00 - 17.00

Vendi: Godina e ZRRE-së

Pjesëmarrës: 31

Ju lutemi referojuni materialit: Draft Metodologjia e Tarifave (26 sllajde).

Prezantimi nga Nick Frydas, Kryesues dhe Shef i ZRRE-së

Sipas Nenit 46 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i ZRRE-së do të zhvillojë dhe nxjerrë Metodologjinë e Tarifave. Kjo rregullon çmimet në sektorin e rregulluar, në përputhje me Modelin e Tregut dhe me teknikat më moderne që kanë të bëjnë me efikasitetet që do të pasqyrohen në çmime.

Një nga konceptet madhore të industrisë së rregulluar të energjisë elektrike, është që konsumatorët nuk duhet të mbajnë koston e plotë të ndërmarrjes së energjisë elektrike. Kompanitë e energjisë elektrike gjithashtu marrin një pjesë të rreziqeve që janë përshirë në Metodologjinë tonë të Tarifave të bazuar mbi stimujt.

Znj. Theranda Beqiri, Anëtare e Bordit të ZRRE-së dhe Shefe e Departamentit të Çmimeve dhe Tarifave, prezantoi veten dhe iu referua dëgjimit publik mbi Rregullin mbi Çmim-vënien (26 shtator 2005), ku u premtua se ne do të mbanim një dëgjim publik mbi Metodologjinë e Tarifave. Theranda po bën prezantimin.

Slide 6: përmbajtja e metodologjisë

William Derbyshire (WD): si sqarim, certifikatat e origjinës janë për gjeneratorët me burime të ripërtëritshme. Sipas ligjit, lejohet të shitet me tarifa të rregulluara të përcaktuara nga ZRRE-ja. Kjo tarifë është më e lartë se çmimi i tregut, në mënyrë që investitorëve t'u jepen stimuj për të investuar në burimet e ripërtëritshme.

Slide 7: Blerjet e energjisë prej furnizuesit publik

WD: KEK dominon tregun e energjisë elektrike me shumicë, dhe si pasojë draft rregullat e tregut marrin masa për përdorimin e një modeli simulues të tregut për të përcaktuar çmimet e rregulluara të tregut për prodhimin e KEK-ut, gjë që lejon mbulimin e kostove të arsyeshme. Operatori i Tregut zhvillon dhe mirëmban modelin sipas rregullave të tregut. ZRRE-ja është përgjegjëse për aprovimin e rregullave të tregut, përfshirë modelin, dhe gjithashtu do të aprovojë hamendjet kryesore të përdorura në model. Qëllimi është të përdoren çmimet që rrjedhin prej modelit simulues për të përcaktuar që furnizues publik të paguajë një çmim të rregulluar për blerjet e energjisë.

Slide 8: Shitjet e energjisë prej furnizuesit publik

Nick Frydas (NF): Ne kemi zhvilluar një mekanizëm stimulues mbi OST dhe OSSH për të minimizuar humbjet.

WD: qasja kryesore është që OST-ja është përgjegjëse për humbjet reale gjatë transmetimit. Furnizuesi do të paguajë për ato humbje dhe do të kompensohet plotësisht nga OST-ja. Ky i fundit mund të përfshijë një nivel të arsyeshëm të kostos së lejuar, që në përfundim përdoret nga tarifat e përdoruesve. Nëse humbjet janë më të larta se niveli i arsyeshëm i humbjeve të përcaktuar nga ZRRE-ja, atëherë diferenca duhet të mbahet nga OST-ja. Nëse humbjet teknike janë më të ulëta se niveli i arsyeshëm i humbjeve, përcaktuar nga ZRRE-ja, atëherë diferencën e mban ZRRE-ja. Kjo krijon për OST-në një stimul të fortë për të mundur nivelin e humbjeve të përcaktuar nga ZRRE-ja.

Një qasje e ngjashme aplikohet për humbjet gjatë transmetimit të cilat paguhen nga OSSH-ja. Sidoqoftë, duke marrë parasysh madhësinë e humbjeve komerciale në rrjetin e shpërndarjes, duhet hetuar fizibiliteti i mbulimit të këtyre prej tarifave të përdoruesve, ose me anë të një kompensimi të para-përcaktuar, që paguar nga BKK-ja.

NF: do të ketë një tarifë pakice sipas nivelit të Kv: 220 Kv, 110 Kv dhe kështu me radhë.

Pyetje: me çfarë çmimi vlerësohen humbjet në shpërndarje?

Përgjigje:

WD: me çmimin e tregut të shumicës të energjisë elektrike, i cili është edhe çmimi që paguhet nga furnizuesit për të blerë këto humbje.

Pyetje: A duhet që humbjet komerciale t'i përcaktojë Furnizuesi Publik dhe a do ta kompensojë OSSH-ja atë?

Përgjigje:

WD: Furnizuesi Publik nuk ekspozohet ndaj humbjeve komerciale përpara njehsorit të konsumatorit, pasi kjo është një "përcjellje" nga OSSH dhe OST. OSSH-ja është e ekspozuar nëse nuk ka pakësuar humbjet teknike dhe komerciale.

NS: Furnizuesi Publik është i ekspozuar ndaj rrezikut balancues dhe për këtë arsye duhet të bëjë një parashikim sa më të kujdesshëm që t jetë e mundur: kërkesën gjatë çdo ore dhe për çdo vit paraprakisht.

WD: Parimi është që të shpërndahen kosto për palët të cilat e kontrollojnë atë. Furnizuesi publik nuk mund të kontrollojë lidhjet e paligjshme, por OSSH-ja mundet dhe duhet të marrë përgjegjësinë për këto humbje komerciale. Furnizuesi Publik mund të kontrollojë humbjet gjatë mbledhjes pasi ata i shpërndajnë faturat dhe mbledhin paratë.

Pyetje: Pse duhet të kontribuojë BKK-ja për pagimin e humbjeve të lejuara, dhe a i ul kjo gjë stimujt për të prerë humbjet?

Përgjigje:

WD: Arsyeja për kontributin e BKK-së është që të mbajë tarifat më të ulëta se ç'mund të jenë. Nuk mundemi t'i bëjmë humbjet e larta komerciale zero brenda natës dhe përfshirë koston e plotë të atyre humbjeve në tarifa, do të nënkuptonte një rritje të madhe në faturat e konsumatorëve. Subvencioni i BKK-së do të ishte vetëm për një periudhë kalimtare.

NF: në këtë metodologji, ne pakësojmë përqindjen e humbjeve të lejuara gjatë kohës. Nëse synimi i përcaktuar është 30% për humbjet komerciale gjatë një viti, BKK-ja nuk do të mbulojë 10% e tepërt dhe kjo do të shkojë në shpenzime të OSSH-së.

Pyetje: a përfshin qasja e propozuar ndër-subvencionimin për humbjet komerciale në tarifa, në kundërshtim me detyrat ligjore të ZRRE-së?

Përgjigje:

WD: ekzistojnë disa humbje komerciale në kostot e lejuara dhe ne besojmë se për t'i shpënë humbjet komerciale deri në 0, do të na nevojitet kohë. Ndërkohë ne pranojmë që ndërmarrja nuk mund të mbulojë këtë kosto.

Është e vërtetë se përfshirja e humbjeve komerciale në tarifa do t'i udhëheqë konsumatorët në tensione më të larta të cilët kanë gjasa të jenë konsumatorë komercialë dhe industrialë, të cilët paguajnë një pjesë të humbjeve komerciale, edhe pse kryesisht ato shkaktohen nga konsumatorët shtëpiakë me tension më të ulët. Sidoqoftë, ky element i ndër-subvencionit është kryesisht i kompensuar nga shfrytëzimi i tarifave të shpërndarjes që diferencohen sipas tensionit, ku konsumatorët e lidhur me nivele më të ulët paguajnë tarifa më të larta në pranim të një pjese më të madhe të aseteve të sistemit që ata përdorin, dhe humbjeve më të mëdha në këtë nivel.

NF: Nuk është një situatë e lehtë dhe ndër-subvencioni ndodh efektivisht sipas çdo lloji qasjeje. Nëse BKK-ja paguan subvencionet, atëherë kjo shpie që taksapaguesit do të paguajnë për kostot e këtyre humbjeve, edhe pse mund të mos jenë këta ata që i shkaktojnë humbjet.

Një pikë e rëndësishme është që të jepet stimulim që merr përgjegjësinë e mbledhjes së ulët të të ardhurave vjetore, që në lidhje me shkëputjet dhe lidhjet e paligjshme e bën OSSH-ja; Furnizuesi nuk merr para për faturat e lëshuara.

Pyetje: Për sa vjet do t'i pakësojë humbjet stimulimi ndaj OSSH-së?

Përgjigje:

WD: Kjo ka nevojë të përcaktohet. Ministria e Energjisë dhe Minierave tashmë ka përcaktuar një synim të propozuar. Një qasje mund të jetë që të kërkohet që brenda një periudhe 2 ose 3 vjeçare, humbjet të ulen deri në nivelet që kanë vendet si Rumania.

NF: Synimet duhet që të jenë në marrëveshje me Qeverinë dhe duhet bërë një përpjekje e madhe në Task Force, Polici dhe Gjykatë. Sërisht, unë theksoj se kjo metodologji tarifash jep stimujt për uljen e humbjeve si dhe të humbjeve teknike.

Kundërshtime:

NF: në mënyrë që OSSH-ja dhe të licencuarit e tjerë të përgjigjen ndaj stimujve, kjo kërkon që ata të rrezikojnë për falimentim. Më pas, duhet të rishqyrtohet i gjithë ambienti qeveritar dhe social. Menaxhimi i OSSH-së duhet të largohet nga detyra në rast se ata mbështeten vetëm mbi subvencionet.

WD: Pagat e menaxhimit duhet të lidhen me fitimet që ata prodhojnë. Stimujt kërkojnë që menaxherët t'i përgjigjen fitimeve.

NF: Ka përbërës të tjerë të politikës sociale që duhet të merren parasysh!

Slide 10: Mbulimi i borxheve të këqija

WD: Supozimi është se normat e mbledhjes përmirësohen me kalimin e kohës dhe kjo do të reflektohet nga subvencionet. Nëse norma e mbledhjes rritet, atëherë subvencionet do të zbresin. Diferenca midis normës reale të mbledhjes dhe normës së synuar, është rrezik për furnizuesin. Është puna e tyre që të mbledhin paratë.

Slide 11: Tarifa Sociale

WD: Një pikë e rëndësishme është që kjo tarifë sociale vlen vetëm për shtëpiakët (amvisërinë) dhe do të ndodhë brenda kategorisë shtëpiake e jo midis kategorive të konsumatorëve. Metodologjia e Tarifave vendos parimin e tarifës sociale duke përdorur sistemin e “ndërtimit të blloqeve” (rising block) dhe ZRRE-ja pret që një tarifë të tillë të ofrohet. Skicimi i detajuar i tarifës sociale do të jetë përgjegjësi e konsulentëve të punësuar nga Projekti ESTAP III i Bankës Botërore.



: A do mbeten brenda kompanisë fitimet e tepërta që janë fituar përgjatë efikasiteteve? A nuk është më mirë që një pjesë t'i shkojë publikut?

Përgjigje:

NF: Ndarja e fitimeve shtesë do të ulë stimulim mbi menaxherët për të bërë që efikasitetet e kostos të kërkuara, të prodhojnë këto fitime. Konsumatorët do të përfitojnë prej zbritjes që rezulton në çmime, për t'u përshtatur me nivelet e reja efikase të kostos që do të bëhen brenda tre vjetëve gjatë shqyrtimit të ardhshëm të çmimeve.

Pyetje vijuese:

Në parim unë bie dakord. Sidoqoftë, në vende të tjera ata ndajnë fitimet e efikasitetit pa hezitim, në mënyrë që të ndihmojnë në tejkalimin e kundërshtimeve ndaj reformave. Cila është përvoja e konsulentit?

Përgjigje:

WD: Të dy këndvështrimet vlejnë. Është detyrë e ZRRE-së që të balancojë interesin e mbështetësve, si dhe interesin e konsumatorëve për të parë kostot e ulura, por edhe interesin e kompanive përfshirë dhënien e një stimuli për to që të pakësojnë kostot. Asnjë regjim rregullator nuk mund të mbijetojë nëse kompanitë bëjnë fitime gjigante.

Ndarja e fitimeve është një mjet për mbrojtjen kundër këtij rreziku. Qasja e miratuar nga metodologjia, është e ndryshme. Në periudhën e parë të kontrollit të çmimit do të jetë e vështirë të bëhen parashikime të kujdesshme të kostove dhe vëllimeve. Për këtë arsye, mund të jetë një rrezik për përfitime jashtëzakonisht të larta ose të ulëta të shkaktuara nga gabimet në parashikim. Në vend që të ndajë përfitimet, metodologjia siguron një rihapje të kontrollit të çmimeve në rast se fitimet lëvizin jashtë një kufiri të arsyeshëm. Kjo duket të jetë më e pastër dhe ofron mbrojtje kundër rezultateve ekstreme.

NF: Duhet të mbajmë mend se kur diskutojmë mbi kontrollin e çmimit të propozuar të transmetimit, kjo përfaqëson vetëm rreth 7 % të çmimit përfundimtar të konsumatorit. Ndarja e fitimit dhe mekanizma të ngjashëm do të kenë pak ndikim mbi çmimet e konsumatorëve, por do të kenë ndikime madhore mbi stimujt e OST-së për të përmirësuar shërbimet.

Slide 14: Ndarja para -2005/pas-2005

WD: Borxhet e para-1999 të përdorura për të financuar asetet e KEK-ut mbahen prej EPS (Ndërmarrja e energjisë elektrike e Serbisë).

NF: Korrigjim : Slide 15: 'Vlera e asetit' në vend të 'jeta e asetit'.

Komentet e pjesëmarrësve: Shpërndarja e borxheve në KEK duhet të zgjidhet gjatë bisedimeve për statusin përfundimtar. Vini re se një pjesë e investimeve pas-1999 janë financuar prej BKK-së dhe jo direkt nga donatorët.

Pyetje: A është faktori X me të vërtetë një rregullim dhe a do të jetë konstant me kalimin e kohës? Cila është masa e CPI-së në formulën rregulluese?

Përgjigje: WD: Faktori X përfaqëson ndryshimin vjetor në kostot reale dhe në përgjithësi do të fiksohet për çdo periudhë të kontrollit të çmimit. CPI është treguesi i çmimit të konsumatorit dhe përfaqëson inflacionin (ndryshimet nominale të kostos). CPI-ja botohet çdo muaj nga Zyra Statistikore e Kosovës dhe mund të përdoret për këtë qëllim, ose nëse kjo nuk konsiderohet si e besueshme, mund të përdoret treguesi i një zone evropiane në vend të saj.

Slide 19: Tarifat e thella dhe të cekëta të lidhjes

NF: Sipas Metodologjisë së Tarifave, Pala e lidhur do të paguajë koston e lidhjes si një shumë të përgjithshme. Nuk është realiste të presësh që OST/OSH të “japin hua” për konsumatorët në rrethanat aktuale kosovare.

Slide 20: Struktura e Tarifave TUOS - 1

NF: Niveli i tarifave TUOS duhet të bazohet mbi një mesatare të kërkesës së pikut gjatë tre kohëve të zgjedhura (p.sh. tre) dhe jo një periudhe të vetme.

WD: Sistemi britanik aplikon një triadë dhe përlllogaritja e tarifave është mesatarja e tre kulmeve më të lartë të vitit, të ndara në kohë të paktën nga dy javë.

NF: këndvështrimi i ZRRE-së është që triada është një mekanizëm që duhet të aplikohet.

Slide 26: Lidhja shpërndarëse dhe tarifat e DUOS

Pyetje: A paguan një konsumator më i vogël tarifë standarde?

Përgjigje:

WD: Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji që do të nxirren nga ZRRE-ja, japin më shumë informacion në lidhje me lidhjen në rrjet dhe kur do të aplikohet një tarifë standarde dhe kostot reale. Pritshmëria është që kostot reale do të aplikohen për konsumatorët për të cilët kostot e lidhjes kanë gjasa të kalojnë tarifën standarde me një shumë të madhe. Pragu do të vendoset nga ZRRE-ja dhe ka gjasa të përfshijë edhe distancën prej rrjetit ekzistues dhe koston.

Kundërshtim: Gjeneratorët nuk duhet të paguajnë tarifë të thellë të lidhjes në mënyrë që të tërheqin investime.!

Përgjigje:

NF: mbulimi i kostove, p.sh. të një gjeneratori të madh të ndërtuar për eksport, prej shfrytëzimit të tarifave të sistemit që aplikohen ndaj të gjithë shfrytëzuesve, nënkupton se konsumatorët e tjerë subvencionojnë kostot e një gjeneratori eksportues.

Ekziston një shqetësim se disa përfitojnë pa shumë mund, si p.sh. ku disa shfrytëzues paguajnë për një lidhje dhe më pas një shfrytëzues i mëvonshëm lidhet dhe i shfrytëzon ato asete pa paguar fare për to. A duhet të lejohet një kusht që të gjithë shfrytëzuesit që paguajnë tarifa të thella të lidhjes dhe lidhen p.sh. brenda 6 muajve ose një viti, të ndajnë kostot me njëri-tjetrin?

WD: qasja tipike është se pala që është lidhur më herët në rrjet, financon atë që është më e nevojshme, dhe i paguhet një shumë kompensues prej shfrytëzuesve që lidhen në rrjet brenda një periudhe të arsyeshme kohore, si p.sh 7 vjet, siç është përmendur aktualisht në metodologji, dhe midis atyre që shfrytëzojnë të njëjtat asete.

Letër nga Ibër Lepenci, drejtuar ZRRE-së, më datë 7 nëntor 2005

Janë marrë komente të shkruara në lidhje me kriterin e përdorur për të formuar kosto të arsyeshme të ZRRE-së dhe ku deklarohet se këto duhet të mbulohen nga gjeneratorët në raport me prodhimin e tyre, si dhe është kërkuar për përpunim të kushteve, sipas të cilëve licencat e dhëna nga ZRRE-ja mund të anulohen. Edhe pse këto komente kanë të bëjnë me Metodologjinë e Tarifave, ato duket se më shumë lidhen me rregullat e ZRRE-së mbi licencimin dhe Planin e tarifave të licencave, dhe ato do të trajtohen gjatë konsultimeve mbi këto çështje.

Koment prej një pjesëmarrësi

Përkthimi i prezantimit në shqip është shumë i keq. Nuk është i kuptueshëm dhe termat teknikë janë të gabuar.

Përgjigje:

NF: Ne i kuptojmë vështirësitë e shkaktuara nga përkthimi i dobët, i cili rrjedh si pasojë e mungesës së burimeve në këtë fushë. Meqë dokumentet origjinale janë shkruar në anglisht, ekziston një dispozitë në Rregullin mbi Vënien e Çmimeve ku në rast se ka ndryshime, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

Përmbyllja prej Nick Frydas

Më 13 dhjetor 2005, ZRRE-ja do të mblidhet publikisht për të votuar shpalljen e Metodologjisë së Tarifave. Deri atëherë, mirëpresim të gjithë komentet mbi Metodologjinë e Tarifave.